



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 611/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Klevens Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.08.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit KVO-së datë 19.06.2017 për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Ferit Myftari” P. F në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF 13633-05-17-2017, me objekt “*Blerje Kancelarie dhe Tонера*” me fond limit 982.580 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 19.06.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë.

Ankimues:

“Ferit Myftari” P. F sh.p.k
Lagjia “18 Shtatori” Gjirokastër.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kolonjë
Sheshi “Rilindja”.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.05.2017 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF-13633-05-17-2017, me objekt “*Blerje Kancelarie dhe Tонера*” me fond limit 982.580 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 19.06.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë.

II.2 . Në datën 09.06.2017 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 19.06.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “Ilirian Bulku”	pa ofertë	I skualifikuar
2. “Euro Office”	pa ofertë	I skualifikuar
3. “Robert Stefanidhi”	pa ofertë	I skualifikuar
4. “Sajmir Mema”	pa ofertë	I skualifikuar
5. “Ferit Myftari”	948.650 lekë	I skualifikuar

II.3.1. Operatori ekonomik ankimues “Ferit Myftari” P. F është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se: *1. “Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar pikën 2.2.2, Pasi pasqyrat financiare të vitit 2014-2015 nuk janë të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve përkatëse, pasi në të gjitha pasqyrat financiare që kanë vlerat e bilanceve nuk ka asnjë nënshkrim dhe vulë të drejtorisë së tatimeve për konfirmim;. 2. Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik pikën 2.3.6, Ky operator ekonomik nuk ka dorëzuar Certifikatat ISO ose ekuivalente për objektin e prokurimit. Pra dokumentet e dorëzuara nuk janë paraqitur sipas pikës 2.3.6, çertifikatat ISO nuk janë të vlefshme pasi aktiviteti i tyre nuk është objekt prokurimit;. 3. Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik pikën 2.3.7, Pasi ky operator ekonomik nuk ka dorëzuar vërtetim/deklaratë/autorizim (nëse është në gjuhë të huaj duhet e përkthyer dhe e noterizuar) për specifikimet teknike nga prodhuesi, ku të gjejnë pasqyrim specifikimet teknike për artikullin letër A4, sipas specifikimeve teknike të kërkuara.*

II.4. Në datën 22.06.2017, operatori ekonomik ankimues “Ferit Myftari” P. F, ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për s’kualifikimin e ofertës së tij nga procedurën e mësipërme të prokurimit me argumentat se:

- *Subjekti “Ferit Myftari” P. F, ashtu si dhe lehtësisht mund të verifikohet në sistem, ka dorëzuar kopje të bilanceve të viteve 2014-2015-2016, të konfirmuara nga Dega e Tatim Taksave Gjirokastër, në të cilën është vendosur dhe nr i protokollit në datën e dorëzimit. Gjithashtu, Pasqyrat Financiare janë konfirmuar nga Eksperti Kontabël A. R, me nr License 96.*
- *Përsa i përket pretendimit se nuk janë dorëzuar certifikatat ISO 9001:2008, Standart për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, ju bëjmë me dije se certifikatat e dorëzuara nga subjekti “Ferit Myftari” P. F, janë plotësisht të vlefshme dhe u përgjigjen të gjitha specifikimeve të vendosura nga ana juaj, gjithashtu certifikatat e paraqitura janë të përkthyer. Përveç kësaj nga ana jonë janë dorëzuar deklaratat për përmbushjen e të gjitha specifikimeve teknike, të vendosura nga ana juaj, e cila është dhe kërkesa ligjore e përcaktuar në DST dhe që njihet ligjërisht. Të gjitha zgjatimet që vendosen nga ana juaj janë për të çoroditur operatorët ekonomik.*

Sa më lartë kërkojmë rishikimin e vendimit të KVO-së dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “Ferit Myftari” P. F, pasi oferat jonë I plotëson të gjitha kërkesat e autoritetit kontraktor.

III.4.2. Në datën 27.06.2017 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1898 prot i kthen përgjigje palës ankimuese duke vendosur refuzimin e ankesës.

II.5. Në datën 04.07.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtën objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Me shkresën nr 2039 prot, datë 12.07.2017, protokolluar me tonën me shkresës nr. 1208/2 datë 13.07.2017, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Ferit Myftari” P. F, mbi skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se “Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti teknik pika 2.3.6, Pas nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Ferit Myftari” P.F, ky operator nuk ka dorëzuar Çertifikatat ISO ose ekuivalente për objektin e prokurimit. Pra, dokumentet e dorezuara nuk janë paraqitur sipas pikës 2.3.6 certifikatat ISO nuk janë të vlefshme pasi aktiviteti i tyre nuk është objekt i prokurimit., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.6 kapaciteti teknik të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është kërkuar si më poshtë:

Operatorët ekonomik duhet të paraqesin Certifikata ISO ose ekuivalente për objektin e prokurimit:

1. - *Certifikatë ISO 9001-2008 – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë (e vlefshme)*
2. - *Certifikate ISO 9001-2008 – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë (e vlefshme) për të gjitha produktet e kërkuar në preventiv.*

VO: Nëse certifikata është në gjuhë të huaj duhet të shoqerohet me përkthimin e gjuhes shqipe të noterizuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatat përkatëse.

III.1.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, (S.P.E.) operatori ekonomik ankimues “Ferit Myftari” P. F, në përmbushje të kriterit sa më sipër ka paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- *Certifikatë ISO 9001-2008 – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë në gjuhë të huaj, e pa përkthyer, lëshuar për subjektin “Ferit Myftari” P. F., me (numër certifikate 914091505), për objekt veprimtarie “Trading & Supply of All Kinds of Iron & Steel Goods, All Kind of Fabrication Ëork & Pre-Engineering Building, Service Related to Construction, Erection, Commissioning & Installation”.*
- *Certifikatë ISO 9001-2008 – Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilesisë në gjuhë të huaj, e përkthyer por e pa noterizuar, lëshuar për subjektin “Qëndër Informacion Kompjuteri A. K, G. S. me numër certifikate 602/Δ/200, të pa specifikuar objektin e veprimtarisë.*

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti

kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”. “Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë....”.

Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.1.4. Referuar seksionit II të dokumentave të tenderit “Udhëzime për operatorët ekonomikë” ku përcaktohet se: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në këto dokumenta, pasi ankimuesi është i detyruar të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, të paraqesë çdo dokumentacion që përmban të dhëna dhe elementë që janë gjykuar të nevojshëm dhe të domosdoshëm nga ana e këtij të fundit.

III.1.5. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Ferit Myftari” P. F, konkretisht certifikatave ISO 9001:2008 të sistemit të menxhimit të cilësisë konstatohet se objekti i veprimtarisë për të cilin janë lëshuar certifikatat e sistemit të menxhimit të cilësisë është i ndryshëm nga ai i kërkuar dhe përcaktuar shprehimisht nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Konkretisht Komisioni konstaton se në kriterin e vecantë të kualifikimit përcaktohet shprehimisht se ofertuesi duhet që të paraqesë “Certifikatën ISO 9001:2008 për të gjitha produktet e kërkuara në preventiv” konkretisht “në fushën e prodhimit të bojës së shtypit, letrës së shtypit dhe nënproduktet e saj.” ndërsa konstatohet se objekti për të cilin është lëshuar certifikatat e cilësisë të dorëzuara nga ankimuesi në këtë procedurë prokurimi është “Tregëtim, furnizim i të gjitha llojeve të hekurit dhe mallrave të çelikut, të gjitha llojet e punëve të fabrikimit dhe ndërtesave para inxhinierike, shërbime të lidhura me ndërtimin, ngritjen, komisionim (proçesi i verifikimit të ndërtimeve të reja për disa nënsisteme) dhe instalimin”.

III.1.6. Sa më sipër Komisioni gjykon se operatori ekonomik ankimues me anë të dokumentacionit të paraqitur nuk ka aritur të përmbushë kriterin e vecantë të kualifikimit pasi dukshëm ekziston një mospërputhje midis objektit të veprimtarisë për të cilin autoriteti kontraktor ka kërkuar paraqitjen e certifikatës së cilësisë ISO dhe objektit të certifikatave të cilësisë që ka dorëzuar ankimuesi. Në rastin konkret objekti për të cilin është certifikuar ankimuesi nuk përputhet në asnjë rast me atë të kërkuar nga autoriteti kontraktor në këtë procedurë prokurimi. Jo më kot autoriteti kontraktor ka lënë të hapur në kriterin e sipërcituar për të gjithë operatorët ekonomikë mundësinë për të paraqitur certifikatat e cilësisë për të gjithë produktet e kërkuara në preventiv. Në rastin konkret ankimuesi me vullnetin e tij ka paraqitur certifikata të cilësisë në emër të tij por që në vetvete nuk kanë asnjë korelacion me atë të kërkuar nga autoriteti kontraktor duke mos dëshmuar kështu në asnjë rast se plotëson kapacitetet e kërkuara lidhur me certifikata të cilësisë me objekt në fushën e prodhimit të bojës së shtypit dhe të letrës apo dhe nënprodukteve të saj.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma "b", të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, i cili parashikon se: "[...] *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]*". Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik duhet të dorëzojë të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.1.9. Bazuar në sa më sipër KPP sqaron se në një procedurë prokurimi subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me *lex specialis*. Sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomikë "Ferit Myftari" P. F, nuk i përmbush kriteret dhe kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit "Ferit Myftari" P. F, nuk qëndron

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues "Ferit Myftari" P. F, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe ky operator vazhdon të mbetet i skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij bashkimi e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ

Përsa më sipër në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 "*Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues “Ferit Myftari” P. F, për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF 13633-05-17-2017, me objekt “*Blerje Kancelarie dhe Tонера*” me fond limit 982.580 lekë pa TVSH, procedurë e zhvilluar në datën 19.06.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Kolonjë.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për shqyrtimin e mosmarrëveshjes administrative.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1208 Protokoli; Datë 04.07.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha

